



## Oda e Stomatologëve të Kosovës

### Stomatološka Komora Kosova • Dental Chamber of Kosovo

**Kuvendi i Odës së Stomatologëve të Kosovës (OSK-së)** në mbështetje të nenit 19, paragrafi 1, me nënparagrafin 1.3 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë nr.04/L-150, nenit 20, paragrafi 1, me nënparagrafin 1.3 të Statutit të Odës së Stomatologëve të Kosovës dhe nenit 41, paragrafi 3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative nr.05/L-031, përmes votimit qarkullues të përfunduar me **datë 17 korrik 2020** miraton këtë:

### V E N D I M

- I. Miratohet Plani i punës së Odës së Stomatologëve të Kosovës për periudhën prill 2020 – mars 2021.
- II. Programi i punës i miratuar i bashkangjitet këtij vendimi si shtojcë.
- III. . Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### Arsyetim

Duke parë se situata e krijuar së fundi me pandemi vetëm sa po përkeqësohej dhe vendimin e Qeverisë së Kosovës nr. 11/09 të datës 1 korrik 2020 i cili në pikën e parë, paragrafi 1.21. ka ndaluar grumbullimin në hapsira të mbyllura dhe të hapura për më shumë se 50 persona, në pamundësi për organizim të Kuvendit, në mbështetje të neni 41 të Ligjit të Procedurës

Administrative nr 05/L-031 i është dërguar raporti i punës së organeve të OSK-së për miratim me votim qarkullues i cili është zhvilluar nga data 15 Korrik deri më datën 17 Korrik.  
Pas mbylljes së afatit për votim Kuvendi vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi.



Kryetari i OSK-së  
Prof.Dr. Blerim Kamberi